



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 388/6 prot.

Tiranë, më 02.10.2020

VENDIM
Nr.108, datë 02.10.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 68, DATË 17.07.2020, NË
INSTITUCIONIN BASHKIA PATOS

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 68, dt. 17.07.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Patos, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar

procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë Patos, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 1165/1 prot., datë 09.06.2020, ka raportuar se, megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, vazhdojnë ende të jenë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunësit: ***** (datëlindja 09.03.1955), në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Bujqësor, Blegtoral, Pyjor, Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 19.03.2020 dhe ***** (datëlindja 16.03.1955), në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Monitorimit të Shërbimeve”, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 16.03.2020.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Patos, vendimin paralajmërues me Nr. 68, dt. 17.07.2020, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Patos, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia Patos, me shkresën nr.1165/4 prot., datë 05.08.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrtur Bashkia Patos, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësin ***** , në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Bujqësor, Blegtoral, Pyjor, Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit” dhe për punonjësin ***** , në pozicionin e punës “Drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Monitorimit të Shërbimeve”.
2. Pozicionet respektive të punës, u shpallën pozicione të lira, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 68, dt. 17.07.2020, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Patos, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Patos.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Patos.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha